



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA
Azienda Unità Sanitaria Locale di Modena

PAPtest

Je një grua në moshën nga 25 deri në 64 vjeç? Të ftojme në mbrojtjen e shëndetit tënd. Falë një analize falas mund të parandalosh tumorin e qafës së mitrës!

Tumori i qafës së mitrës zhvillohet me ngadalë dhe nëse nuk kurohet në kohë mund të sjelli pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e gruas.

Në fillim nuk shihet me një vizitë të thjeshtë tek gjinekologu, por mund të diagnostikohet me një analizë që quhet PAP TEST.

Çfarë është programi i parandalimit të tumorit në qafën e mitrës?

Çdo grua në moshën nga 25 deri në 64 vjeç ftohet, me anë të një letre, çdo tre vjet për të bërë PAP TESTIN. Kjo analizë bën të mundur të zbulohet sëmundja edhe kur nuk ka akoma simptoma dhe të kapen anomalitete që nuk janë akoma forma tumorale, por nëse nuk kurohen mund të kenë bëhen të tilla. Duke vepruar në këtë mënyrë, kurimet e mundshme janë më pak agresivë dhe dramatikë dhe japin më shumë shpresë shërimi dhe rikthimi në formë të shëndetshme.

Çfarë është pap testi?

Është një analizë e thjeshtë dhe pa dhimbje që zgjat vetëm pak minuta. Kjo analizë bëhet duke marrë pak material (qeliza) nga qafa e mitrës me anë të një luge të vogël apo të një furçe për ta ekzaminuar në mikroskop. Bëhet vetëm nga një trup sanitar femëror (mami).

Gjëra të tjera që duhen ditur:

- Kjo analizë nuk mund të bëhet gjatë ditëve të menstruacioneve
- Evito përdorimin e supostave, kremave dhe larjeve të brendshme të vaginës për pesë ditë para analizës.
- Evito raportet seksuale gjatë 24 orëve para analizës.
- Nuk duhet kërkesa e mjekut tuaj.
- Çdo hap i programit të parandalimit i nënshtrohet kontrolleve të kualitetit.

Në disa raste ndodh që analizës mund ti shpëtojnë pa diagnostikuar dëmtime të qafës së mitrës edhe pse janë të pranishme. Duhet mbajtur mend që dëmtimet tumorale shpesh herë nuk sjellin dëmtime më të rënda dhe mund të shërohen vetvetiu.

Sa kushton?

Kjo analizë dhe kurimet e mundshme janë falas për gratë që marrin letrën e ftesës nga Azienda Sanitaria (AUSL).

Kur dhe si jepet rrezultati i analizës?

Rrezultati i analizës, nëse negativ (domethënë që nuk ka shenja të tumorit) jepet me anë të një letre që vjen në shtëpi. Në rast të kundërt, nëse ka ndonjë problem apo dyshim do të të marrin në telefon për tu vënë dakort mbi vizita dhe analiza mjeksore të mëtejshme.

PËR GJITHË KËTO ARSYE ËSHTË E RËNDËSISHME QË TË BËHET PAP TESTI EDHE KUR JE MIRË ME SHËNDET PAP TESTI ËSHTË FALAS, I THJESHTË PËR TU BËRË DHE MUND TË TË SHPËTOJË JETËN

Për të marrë informacion telefono në konsultoren më të afërme:

Carpi: Via Don Luigi Sturzo, 21 – tel: 059/6554170

Castelfranco: Corso Martiri, 368 – tel: 059/929508

Mirandola: Via Lino Smerieri, 3 – tel: 0535/602815

Modena: Via Molza, 3 – tel: 059/2134359

Via Don Minzoni, 121 – tel: 059/2134006

Pavullo: Viale Martiri, 63 – tel: 0536/29369

Sassuolo: Via Cavallotti, 136 – tel: 0536/863788

Vignola: Via XXV aprile – tel: 059/777883



PAPtest PAPtest
PAPtest PAPtest
PAPtest